

## **KOALICIONI SIRIANO-SERB KUNDËR SHQIPTARËVE**

Më 12 qershor 2013 në lokalet e huazuara nga Universiteti i Gjenevës është mbajtur një konferencë e titulluar "Trafikimi i organeve dhe armët kimike në konfliktet në Siri dhe Kosovë". Të pranishëm ishin rreth 50-60 pjesëmarrës, prej të cilëve gjysma shqiptar, kurse gjysma tjetër arab – sirian dhe serb, me ndonjë përjashtim të rrallë të nacionaliteteve tjera.

Natyrisht se këto dy tema nuk kishin asgjë të përbashkët.

Në Siri po zhvillohet një konflikt brenda një kombi, që është komb arab, që ka një fe (myslimane), që ka një gjuhë, një kulturë, një traditë dhe një të kaluar të përbashkët mijëvjeçare. Në Kosovë nuk kishte konflikt, por u zhvillua një luftë mes dy popujve që nuk kanë asgjë të përbashkët, përveç bashkëjetesës së dhunshme, pas pushtimit të Kosovës në vitin 1912 nga Serbia. Bashkëjetesë kjo e karakterizuar, nga njëra anë, me kolonizim masiv të Kosovës me serbë, dhe nga ana tjetër me shpërngulje po ashtu masive të shqiptarëve nga Kosova në drejtim të Turqisë (1919-1939); me ripushtimin e Kosovës në vitin 1989-90 kur u mbyllën të gjitha institucionet arsimore, kulturore dhe informative, kurse punëtorët shqiptar u përjashtuan dhunshëm nga puna që shkaktoi shpërnguljen e dytë masive, kësaj radhe në drejtim të Evropës perëndimore, për të përfunduar me dëbimin e një milion shqiptarëve në vitet e luftës 1998-99. Pra, me përpjekje të pareshtura serbe për ndryshimin e strukturës etnike, respektivisht për zhdukjen biologjike të shqiptarëve nga toka e Kosovës.

Megjithatë, konferenca fillon me një reportazh televiziv, 59 sekondash, të përgatitur nga TV Euronews me rastin e përfundimit të gjyqit ndaj të pandehurve në rastin e njohur Medicus, që ka të bëjë me transplantimet ilegale të organeve që janë bërë në Prishtinë në vitet 2007 dhe 2008 në klinikën Medicus ku ishin të përfshirë mjekët turk dhe shqiptar, sikurse edhe dhuruesi(t) e paguar të organeve nga shtetet e lindjes dhe pranuesi(t) nga Izraeli dhe ndonjë shtet tjetër. Në atë kohë në Kosovë nuk kishte asnjë lloj konflikti, apo jo. Pra, një rast tipik kriminal që (mund të) ndodh edhe në shumë shtete tjera, sidomos ato të varfra ku organet shiten dhe blihen sikurse të ishin mallra industriale. Dhe, jo e parëndësishme, në atë kohë Kosova ishte e administruar nga UNMIK-u.

Konferenca vazhdon me një video tjetër ku Carla del Ponte deklaroi se rebelët në Siri paskan përdorur armë kimike; me fjalimet e disa personave të ftuar nga organizatorët që ishin pro Asad, pastaj me disa video morbide, ku shihet se si pushkatohej disa persona të ulur në gjunjë, që domosdoshmërisht ma përkujton Srebrenicën, pastaj kur njëri tjetrit ia këpusin kokën dhe për fund kur njëri tjetrit ia nxjerr zemrën dhe e afron te goja për ta ngrënë . . . . .

E gjitha zgjatë rreth dy orë, pa u përmendur Kosova.

Për fund, si desert, del në skenë ylli i mbrëmjes Vanessa Stojilkovic, një gazetare franceze nga babai serb, që dëshiron të na flas për gënjeshtër mediatike, për faktin se të njëjtat shtete, Amerika, Franca, Anglia, Gjermania, Italia dhe aleatët tjerë, janë shkaktarë të zhbërjes së shtetit të saj më të dashur, Jugosllavisë atëherë, dhe Sirisë sot, dhe jo politika serbomadhe shoviniste në krye me Millosheviqin dhe akademinë e shkencave dhe të arteve të Serbisë. Madje deshi të na tregoj se NATO e paska bombarduar Kosovën dhe jo Serbia, dhe se në luftën e Kosovës në vitet 1998-99 UÇK-ja paska bërë trafikim me organet e serbëve të zënë rob dhe se për këtë kishte "dëshmi", reportazhin nga gjykimi për veprat e vitit 2007-2008, madje deshi të na bind se ne nuk kemi përjetuar asgjë dhe nuk kemi parë asgjë, nuk kemi qenë nëpër burgje, nuk na u kanë vrarë dhe zhdukur me qindra mijëra njerëz gjatë "bashkëjetesës së lumtur" 80 vjeçare, por se të gjitha janë gënjeshtër mediatike, madje deshi edhe të na shfaq një film nga produksioni i saj me kush e di se çfarë përmbajtje, madje, madje . . . .

Thjesht, ishte e padurueshme, arrogante, vulgare, kërcënonte, asnjë argument nuk e ndalte dot. Përveç fishkëllimave. Por, "kija inatin, falja hakin". Ishte manipuluese e mrekullueshme. Për mrekulli manipuloi çështjen e Sirisë për interesat e Serbisë.

Megjithatë, fishkëllimat nuk arritën ta zhbëjnë publikimin në gazetën më të lexuar të Gjenevës, 20 Minutes.

**Ali Mehmeti**

**P.S.** Botuar në albinfo me 14 qershor 2013:

<http://www.albinfo.ch/sq/kultura/konflikti-n-siri-manipulohet-p-r-interesat-e-serbis>